
POSTIM ARKIVOR

At Frano Gjini (1886 - 1948) në dosjet e Sigurimit të Shtetit

11 mars 1948, në sheshin e varrezave të Rrmajit, në Shkodër, u ekzekutuan me vdekje Imzot Frano Gjini, Imzot Nikollë Deda, At' Çiprijan Nika, At' Mati Prenushi



SEKSIONI

Klerikë

PERIUDHA

1975 - 1975

Procesi gjyqësor i vitit 1948 ndaj Monsinjor Frano Gjinit dhe klerikëve françeskanë mbetet një nga proceset më të ashpra të diktaturës komuniste në Shqipëri. Në përfundim të gjyqit, u dhanë këto dënime : Monsinjor Frano Gjini, Dom Nikoll Deda dhe Padër Mati Prendushi u dënuan me vdekje; Dom Tom Laca me burgim të përjetshëm; Padër Gjon Karma dhe Dom Ndoc Sahatçija me nga 15 vjet burg dhe punë të detyruar; Padër Mhill Miraj me 7 vjet; Zef Haxhi dhe Dom Nikoll Shelqeti me nga 5 vjet; ndërsa më i riu në atë kohë, At Zef Pllumi, u dënua me 3 vjet burg dhe punë të detyruar, duke shënuar fillimin e vuajtjeve të tij të gjata. Ky proces përfaqëson një nga goditjet më të forta ndaj klerit shqiptar, duke dëshmuar qartë karakterin represiv dhe politik të drejtësisë së asaj kohe.

PERMBAJTJE #1


Frano Gjini dhe procesi i vitit 1948 në Shkodër: Gjyqi politik kundër klerit katolik dhe dëshmitë nga dosjet e Sigurimit

11 mars 1948, dita kur në sheshin e varrezave të Rrmajit, në Shkodër, u ekzekutuan me vdekje Imzot Frano Gjini, Imzot Nikollë Deda, At Çiprijan Nika, At Mati Prenushi. Dokumentet e proceseve hetimore-gjyqësore shkruajnë se ata u dënuan për “deliktitin e dobësimit të mbrojtjes” si dhe akuzën politike se do të organizonin kryengritjen me armë dhe fshehjen e tyre në kishë e në Kuvendin Françeskan të Shkodrës, një akt i inskenuar nga Sigurimi i Shtetit. Procesi gjyqësor i vitit 1948 ndaj Monsinjorit Frano Gjini konsiderohet një nga gjyqet më të bujshme politike të viteve të para të diktaturës komuniste në Shqipëri. Në këtë proces u dënuan me vdekje ai dhe tre klerikë të tjerë, ndërsa gjashtë të pandehur morën dënime me burgim të gjatë dhe punë të detyruar. Sipas burimeve arkivore, procesi u zhvillua nga Gjykata Ushtarake në Shkodër, me akuza për veprimtari armiqësore, lidhje me misione të huaja dhe përpjekje për organizim politik përmes një partie demokristiane. Ndër të dënuarit ishte edhe Zef Pllumi, i cili mori në këtë proces dënimin e tij të parë me 3 vjet heqje lirie dhe punë të detyruar. Vendimi i janarit 1948 parashikonte: Dënim me vdekje për Frano Gjini, Nikollë Deda dhe Mati Prendushi; Burgim të përjetshëm për Tom Laca; Dënime të rënda me burg për Gjon Karma, Ndoc Sahatçija, Mëhill Miraj, Zef Haxhia, Nikollë Shelqeti dhe Zef Pllumi Në kujtesën publike, ky proces shihet si pjesë e goditjes sistematike ndaj klerit katolik dhe institucioneve fetare, përmes akuzave politike dhe proceseve të montuara. Çfarë përmban dosja në Arkivin e Sigurimit : Fondi 1, Dosja 1302.1a, viti 1975 Dosja hetimore-gjyqësore nr. 1302.1/a e vitit 1975 i përket Ndoc Sahatçisë, një prej të dënuarve në procesin e vitit 1948 kundër klerikëve katolikë në Shkodër. I dënuar fillimisht bashkë me ta , ai përballet sërish me ndjekje penale dekada më vonë, një dëshmi se persekutimi nuk përfundoi me dënimet e para. Në përmbajtjen e dosjes gjenden procesverbale hetimore, akt-akuza, deponime të të pandehurve, ballafaqime me dëshmitarë, pretenca e prokurorit dhe vendime gjyqësore, si dhe dokumente mbi ekzekutimin e disa prej të dënuarve dhe kërkesa të mëvonshme për amnisti. Çështja përfshin figura të njohura të klerit katolik shqiptar, ndër ta Frano Gjini, Mati Prendushi, Nikollë Deda, Tom Laca, Ndoc Sahatçija dhe Zef Pllumi. Dokumentet pasqyrojnë akuzat për organizim komitetesh ilegale, lidhje me misione të huaja dhe përpjekje për krijimin e një partie demokristiane, si dhe qëndrimet mbrojtëse të të pandehurve, të cilët theksojnë karakterin fetar të veprimtarisë së tyre dhe mohojnë çdo aktivitet politik armiqësor. Dosja mbyllet me vendime përfundimtare të organeve gjyqësore ushtarake dhe dokumente mbi ekzekutimin e dënimeve.

MEDIA #1

Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPNIS
GJYKATA USHTARAKE SHKODER

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

Nr 64/III Prot

Shkoder,me I2/3/I948

GJYKATES KALT USHTARAKE

T I R A N E

P. Shkreses Nr 88 date 8/3/I948

Ju njoftojme se te denuemit me vdekje I) Monsior Frano Pjeter Gjini 2) Pater Mati Kol Prendushi dhe 3) Dom Nikoll Deda te gjithe nga Shkodra u eksekutuan me daten II/3/ I948 ora 5 para dite dhe fjala e fundit ka qene :

1) Frano Pjeteri tha se: Rofte Krishti Mbret Feja Katolike,dhe katoliket ne bote, rofte papa,gjaku dhe trupi jem mbetet ketu,por shpirti dhe zemera eshte te Papa,rofte shqipnia

2) Pader Mati Kol Prendushi tha se: Jam i pafajeshme,po vdes ne krye te detyres p'ime,Rofte Krishti Mbret,Rofte Papa, Rofshin Katoliket, Rofte Shiqpnia ,u bej halla Gjyqit dhe ato qe qote shtijen mbi trupat tona te pafajeshme .

3)Dom Nikoll Zef Deda tha se :Rofte Shqipnia po vritem ne punen time,Rofte Krishti Mbret, Rofte Populli Shqiptar

Kryetar' I Gjykates
Kapiten I re
(Misto Bllaci)

67. Regj. 1948

Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin

INFORMACION

Frano Gjini në qendër të procesit të 1948-ës: Ekzekutimi i klerikëve në Shkodër dhe dosjet që zbulojnë persekutimin

FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjyqesore
	380
KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE)	Misto Bllaci


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme

MEDIA FAQE #1



Faqe : 4.

Nga te pandehurit Zef Haxhija ka gene antar i Komitetit Qendror te Demokristjanes.Ka trathetuar besimin e po-ullit ai perfaques i po-po-ullit ne Kuvendin Popullor,dhe u lidhur me organizatat trathetare terroriste,fashiste e prefashiste te cilat ishin per kunder At-dheut dhe po-ullit.

Pere te gjitha keto kerkoj qe te pandehurit te gjesohen fajtor ne baze te neneve 2,3(+ikave 1,2,4,7,8, e 14) te Ligjes Nr.372,mbi fajet penale kunera Shtetit dhe Po-ullit,dhe ne baze te nenit 4 po te kesaj Ligje te maeshkohen si vijon:

1)Per te pandehurit:Monsinjor Frano Gjini,Dom Nikoll Deda,dhe Pader Mati Prendushin dhe Dom Tom Laca me vdekje.

2).-Per te pandehurit: Pader Gjon Karma me 20 vjet privim liri e pune te detyruar.

3).-Per te pandehurin:Dom Jak Shatin me 15 vjet privim liri e pune te detyruar.

3).-Per te pandehurin:Pader Ujkli Miraj me 10 vjet privim liri e pune te detyruar.

4).-Per te pandehurit:Zef Haxhin,dhe Dom Nikoll Shelqetin me nga 5 vjet privim lirie e pune te detyruar.

5).-Per te pandehurin:Zef Pllumbin me 3 vjet privim lirie e pune te detyruar.

Shkoder,me 8/I/1948.-

Prokurori Ushtarak i P.U.SH.
Kariten
(Namik Qemali)

ALBSSH

Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme

INFORMACION

Pretenca e 8 janarit 1948 në Shkodër: Frano Gjini dhe klerikët përballë akuzave politike dhe dënimeve ekstreme

FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjyqesore
KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE)	Namik Qemali
NR. I FLETEVE	380


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

MEDIA FAQE #1



Faqe:67

se ndeshta eshte marre paraysh edhe sinqeriteti im para gjyqit,por shume partizane si Ndoc Mazi e Gjylbegu kane pase bazat tek mua,dhe mbas shlirimit kam enkurajuare punet vullnetare e parinet e sistemit te Rij,megjithe se neve kemi bere edhe arkitasion te kundert.Kam ofrue Oficerave te Levizjes strehim e ushqim e pritje,lutem meshire dhe lehtesim me qene e mundure.

Ivandehuri Pader Gjon Kerma tha: Sikurse kam deftue edhe ne proces dhe para gjyqit nuk dij se kam ba veprim kundra Pushtetit.Kur me ka rene rasti per te folur per pushtet kam folur ne favor(kam predikuare per te).Nuk kam sabotuare Reformat,po perkundrazi e kam kshillue popullin te shikoje punen e vete.Tash gjyqi roft e qofte vendimit duhet me i nderje.

Ivandehuri Dom Tom Laca tha: Une sjam perzier kurre ne politike.Une jam tepër i trembur qe te kem qene ne Demokristjane.Une se pari ekam pdier ate emer kur ube gjyqi.Une s'kam ba gje kundra Shtetit e Popullit.Kur me ka rene rasti kemi ndihmuare njerzit e Levizjes N.C.Une skam dijture kurqje per Komitet se nuk kam pase as prirje dhe ky ndeshkim eshte i tepert lyn meshire.

Ivandehuri Dom Nikoll Deda tha: Me duket mue ndeshkimi Prokurorit i rende se per vece mbeledhjes rastesisht ne Pjeter Deda e Cin Serreqi tjeter s'kam ba,por sic thashe keto kane qene te rastit.Suvenionet ikam marre me titullin "Ndihme Kultit" Pregatitja e tterrenit per ardhjen e Italis nga une ose nga kleri nuk eshte e vertete,as per fashtizimin e popullit.Une kam shkue tek Jakomini ete tjere me lyn ndihma per ngrijtjen e Kishes.Nuk kam qene i lidhure me Gjermane,por kam dhene buke edhe njersve te Levizjes N.C.por edhe gjermaneve per hospitalitet si shqiretar.Une nuk e konsideroj veten fajtor Rofte Shqiperia.Me dashte Zotin migjitheshka dhe shoqin si vedin.

Ivandehuri Pader Nati Prendushi tha: Une nuk kam pase dijeni per Partin Demokristjane.Sa per kundra Pushtetit jam krejt i bindure se s'kam ber asgje,por per ndihma kam dhene njersve te Levizjes N.C. dhe ikam strehue si Injac Ndojen e Cesk Kabashin ikam mbajte nje muej ne Kuvend,po te isha kundra nuk ecaja koken kurre.Nuk kam dhene asnje direktive ose udhezim kundra Pushtetit,po te dale nje jam gati. E ndiej veten te nafajshem Rofte Shqiperia e Shqiretaret.Dhe ne deksha une nuk prish pune.Edij se jam i nafajeshem.

Ivandehuri Monsinjor Frano Gjini tha:Deshmia e Preng Lezajit eshte falso se nuk eshte e vertete.Nuk eshte e vertete edhe ajo e Padre Gurashit qe ti kem then une me ba sabotime ne punetori,por vetem ikam thene se nse punojne te Dielat qe esh-

Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

INFORMACION

Dëshmitë e të pandehurve në procesin e Shkodrës (1948): deklarata mbrojtëse dhe mohime për veprimtari armiqësore ndaj shtetit

FONDI	1
DOSJA	1302/1.a
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore Gjyqesore
	380

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.